



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RESPEKTIMI DHE KUFIZIMI I TË DREJTAVE TË SHTETASVE TË NDODHUR NË KUSHTET E PRIVIMIT TË LIRISË GJATË PANDEMISË GLOBALE COVID-19

BULETIN INFORMATIV

1 TETOR 2020 - 14 JANAR 2021 | NR.2

ÇËSHTJE NË VIJIM:

*Raste të asistuar ligjërisht nga KSHH
dhe përfaqësimi i grupeve më
vulnerabël të shoqërisë - fq.1*

Burgjet dhe Covid-19 - fq.4

*Media, pasqyrë e situatës në
burgje - fq.5*

Raste të asistuara ligjërisht nga KSHH dhe përfaqësimi i grupeve më vulnerabël të shoqërisë

Gjatë periudhës Tetor 2020 - 14 Janar 2021, KSHH ka ofruar asistencë juridike për personat në gjendje të lirë dhe për personat që janë në kushtet e privimit të lirisë. 93 ankesa janë marrë në trajtim, ku nga këto 63 janë këshillime ligjore, 2 asistencë për plotësim dokumentacioni, 17 ndërhyrje institucionale dhe 11 shërbime avokatore falas. Të gjitha ankesat e adresuara nga 70 shtetas të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë (67 në burg dhe 3 në paraburgim) dhe 23 shtetas në gjendje të lirë, janë trajtuar ligjërisht dhe janë adresuar pranë institucioneve kompetente. Objekti i ankesave të shtetasve të paraburgosur/të dënuar kanë qenë ankesa ndaj shërbimit mjekësor (mungesë ilaçesh, mungesë vizitash tek mjeku specialist etj.); asistencë ligjore për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve për refuzim transferimi nga institucionet, kërkesa për shërbim avokator falas apo shkelje e të drejtave dhe lirisë themelore nga stafet institucionale.



"Shtetasi G.Sh i dyshuar për kryerjen e një vepre me rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore ndodhej prej 7 muajsh i paraburgosur. I penduar për veprimin e kryer dhe me probleme kronike të shëndetit mendor, atij i duhej të kujdesej edhe për vajzën e tij të sapolindur. Ai adresoi në rrugë telefonike kërkesën e tij për ndihmë ligjore dhe menjëherë avokatët e KSHH morën në studim rastin. Pas depozitimit të kërkesës për ndryshimin e masës së sigurisë, Gjykata e Rrethit Krujë vendosi pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës "arrest shtëpie" për shtetasin G.Sh.

Shtetasi B.S është dënuar me një masë burgimi relativisht të gjatë. Ai vuan nga probleme shumë të rënda shëndetësore dhe gjatë gjithë kohës së vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje shëmbulllore në IEVP. Ai është një model rehabilitimi, ku gjatë gjithë kohës në institucion ka ndjekur trajnime të ndryshme dhe ka frekuentuar vendet e kultit. KSHH e asiston ligjërisht në kërkesën e tij për aplikimin e alternativës së dënimit me burgimit, "qëndrim në shtëpi".

"Shtetasi N.B i dënuar më një marzh të lartë dënimi, vuan nga probleme të ndryshme shëndetësore. Ai gjatë vuajtjes së dënimit u dyshua si autor i kryerjes së një tjetër vepre penale. Ky shtetas nuk kishte asnjë informacion të komunikuar mbi kërkesën e Prokurorisë për ta vendosur nën masën mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion të posaçëm mjekësor". Pas njohjes me kërkesën e tij në rrugë telefonike, KSHH po përfaqëson ligjërisht falas këtë shtetas në Gjykatë, duke arritur të mundësojë kryerjen e një akti të ri ekspertimi, me synim garantimin e të drejtave procedurale të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventa"



Shtetasi A.S i gjykuar në mungesë pa mundur të dëgjohet nga një gjykatë kompetente është dënuar me një marzh të lartë burgimi. Ai përballet me probleme të shumta të shëndetit, të cilat vështirësojnë jetesën e tij në institucion. I ndodhur në përfundim të kohës së dënimit, ai kërkoi në rrugë telefonike ndihmën e KSHH. Fillimisht shtetasi A.S u këshillua ligjërisht për vënien në lëvizje të institucioneve shtetërore dhe më pas u përfaqësua në gjykatë për të kërkuar qëndrimin në shtëpi.

Shtetasi Xh.K, në gjendje të vështirë ekonomike dhe pa mbështetjen e familjes është gjykuar në mungesë.

Ai nuk është përfaqësuar nga një avokat në këtë gjykim, e në momentin e arrestimit nuk është asistuar nga një mbrojtës për të garantuar të drejtat e tij procedural, për një rigjykim. Pas kërkesës në rrugë telefonike, avokatët e KShH po e asistojnë në kërkesën drejtuar gjykatës për t'u rigjykuar dhe dëgjuar nga një gjykatë kompetente.



Pacientja S.M, një zonjë në moshë të thyer, prej një kohe shumë të gjatë ndodhet nën masën mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor". Pas interesit shumë të lartë të familjes, mbi procesin e saj rehabilitues dhe informimit nga stafi i institucionit se gjendja e saj është në përmirësim të vazhdueshëm, avokatët e KSHH kanë nisur një proces ligjor për t'i bërë të mundur zonjës mjekimin ambulator dhe rikthimin në familje

Shtetasja R.S., 20 vjec pjesë e komunitetit rom, dyshohet për kryerjen e një vepre me rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore dhe ndodhet aktualisht e paraburgosur. Në kushte të vështira ekonomike dhe familjare, ajo po asistohet nga avokatët e KShH pranë Gjykatës së Tiranës, me fokus garantimin e të drejtave të saj procedurale dhe bërjen të mundur që vendimi i gjykatës të mbajë parasysh mundësitë për rehabilitimin e saj

Shtetasi turk B.A dyshohet për kryerjen e një vepre me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Për shkak të mosnjohjes së gjuhës shqipe dhe vështirësive ekonomike ai ndodhet në një situatë delikate shëndetësore dhe sociale. I paraburgosur, e më pas i proceduar në gjendje të lirë, ai ishte përballur me një seri vështirësish në kontakt me institucionet shqiptare, të shkaktuara dhe si pasojë e mosnjohjes së gjuhës shqip dhe mos informimit rreth legjislacionit shqiptar. Aktualisht ai po asistohet ligjërisht nga avokatët e KShH, me fokus bërjen të mundur të kthimit të tij në Turqi



KSHH në rolin "Amicus curiae"

Shtetasi B.M, i paraburgosur dhe i akomoduar në I EVP Korçë, i diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor, ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokate. Prokuroria ka depozituar kërkesë për pushimin e çështjes penale dhe vendosjen e masës mjekësore "mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" ndaj këtij shtetasi. Avokatja e zgjedhur prej tij, pasi kishte dëgjuar për rolin dhe veprimtarinë e KSHH, na u drejtua me kërkesë për depozitim të *amicus curia* drejt Gjykatës. Stafi ligjor i KSHH depozitoi një *amicus curiae*, duke ofruar të dhëna dhe informacione të grumbulluara gjatë misionëve monitoruese në I EVP Zahari (Krujë). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi administrimin e këtij instrumenti të dërguar nga KSHH, si provë, ndërkohë që procesi gjyqësor vijon.

Burgjet dhe Covid - 19

Veprimtaria monitoruese e KSHH në sistemin penitenciar

Edhe në kushtet e pandemisë botërore Covid-19, vëzhguesit e KSHH ndërmorën vizita monitoruese në terren, me fokus evidentimin e nivelit të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në IEVP-të Peqin, Lezhë, Fier dhe 325 "Ali Demi", ku rezultoi se:

- Masa e ndërmarrë për ndalimin e takimeve të shtetasve të burgosur ose paraburgosur me familjarët, ishte jo proporcionale dhe me ndikim të konsiderueshëm në gjendjen psiko-sociale të këtyre shtetasve.
- Ndërmarrja e masave disiplinore dhe shtrënguese ndaj të paraburgosurve/dënuarve hartues dhe nënshkrues të një peticioni publik drejtuar IEVP Peqin dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel epror, i cili synonte nxitjen e proaktivizimit të institucioneve për respektimin e të drejtave, është vlerësuar si ndërhyrje në lirinë e shprehjes.
- U konstatua me shqetësim transferimi i shtetaseve, ndaj të cilave Gjykata ka vendosur masë mjekësore "Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor", nga Spitali i Burgjeve (IVSHB) në IEVP 325. Mënyra e akomodimit të këtyre shtetaseve dhe trajtimi mjekësor i ofruar ishin të papërshtatshme në raport me gjendjen e tyre shëndetësore.
- Kushtet infrastrukturore akomoduese, në një masë të madhe të institucioneve penitenciare shfaqnin problematika të përsëritura

Gjatë realizimit të misionit verifikues në IEVP "Ali Demi" (325), vëzhguesit e KSHH dhe nd/komisionerët e Avokatit të Popullit i referuan stafit institucional gjetjet shqetësues, të cilat krijojnë kushte të trajtimit çjerëzor e degradues. Menjëherë pas kësaj vizite u bë i mundur transferimi i këtyre shtetaseve në Spitalin e Burgjeve (IVSHB)

Rekomandime për Prokurorinë e Përgjithshme dhe stafin mjekësor, mbi dhunën e regjistruar ndaj të miturit A.V. të pretenduar si të shkaktuar nga policë civile

1. Marrjen e masave nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për respektimin e nenit 280 K.Pr.Penale, duke luajtur një rol proaktiv në iniciimin e hetimit me iniciativë lidhur me rastin e të miturit që ka pretenduar dhe për të cilin janë regjistruar shenja dhune.
2. Forma e dokumentimit të shenjave të dhunës nga stafi mjekësor, reflekton një kqyrje/ekzaminim sipërfaqësor, ndërkohë që bën ndesh me rekomandimet e dhëna nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës (KPT), i cili ka sugjeruar realizimin e vlerësimit të qëndrueshmërisë dhe bazueshmërisë së gjetjeve mjekësore dhe pretendimit të realizuar nga ana e individit. Për më tepër, sikurse KPT edhe KSHH vëren me shqetësim mungesën e ndërgjegjësimit të stafit mjekësor të institucioneve të mbyllura mbi detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 282 K.Pr.Penale, për të kallëzuar pranë organit procedues rrethanën e konstatuar

Respektimi i garancive procedurale dhe të drejtave të shtetasve të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë gjatë protestave për vrasjen e të riut K.R. ka qenë në fokusin e KSHH

Nisur nga protestat e zhvilluara në disa qytete të vendit, pas vrasjes së të riut K.R, më datë 15 dhjetor 2020 KSHH ndërmori një mision verifikimi në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatit të Policisë Nr.2. Vetëm në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.2 u bë i mundur intervistimi i 4 shtetasve, ndërkohë që dokumentacioni dhe praktika e mbajtur nga institucionet u verifikua në mënyrë objektive dhe të gjithanshme.

Vëzhguesit e KSHH konstatuan parregullsi në veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga stafet e institucioneve për dokumentimin e të dhënave dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve. Me shqetësim u vërejt mosrespektim i parashikimeve ligjore lidhur me prezencën psikologut dhe kujdestarit ligjor në momentin e verifikimit fizik të të miturit. Evidentimi jo i duhur i arsyes së shoqërimit të protestuesve, duke e cilësuar protesta, vlerësojmë se përbën premisa për cënim të së drejtës së tubimit, parashikuar nga nenet 47 të Kushtetutës dhe 11 KEDNJ.

KSHH iu drejtua me anë të letre zyrtare Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Komisarariatit nr.2, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe për dijeni Pocië së Shtetit ([kliko](#)).



Media, pasqyrë e situatës në burgje

Rekomandime të Komitetit Shqiptar të Helsinkit mbi ruajtjen e marrëdhënieve me jashtë dhe familjarët e tyre ([kliko](#))

Gjatë zbatimit të nismës, me synim ndërgjegjësim në një masë më të gjërë të publikut, gazetarë profesionistë që mbulojnë sistemin penitenciar kontribuan nëpërmjet realizimit të kronikave televizive.

Pandemia u kufizon "lirinë" të miturve në burg, takimet online nuk zëvendësojnë kontaktin me prindin ([kliko](#)).

Pandemia, skandali në burgje/Nuk zbatohet ligji për 300 persona të dënuar me probleme të shëndetit mendor, s'duhet të mbahen në qeli ([kliko](#))



Protestat në burgje, KSHH letër Ministrisë së Drejtësisë: Ja shkeljet ([kliko](#))



Pas vënies në dijeni të faktit se të paraburgosurit/dënuarit e akomoduar në IEVP Peqin kanë depozituar një peticion, ku kërkojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, vëzhguesit e KSHH realizuan një mision verifikimi në këtë institucion. Praktika e refuzimit të ushqimit dhe depozitimit të peticioneve u ndoq dhe nga të akomoduarit në burgjet e tjera të vendit

- ➔ KSHH konstatoi se vendimmarrja për vendosjen e të dënuarit iniciator nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë nuk ishte e analizuar dhe në mbështetje të rrethanave faktike, duke krijuar premisa për cënim të së drejtës për depozitim të kërkesë/ankesave
- ➔ Mungesa e realizimit të konsultave mjekësore në sekuenca të largëta në kohë, trajtimi i shtetasve të dënuar për vepra penale me qëllime terroriste nga staf psiko-social jo i trajnuar dhe përfaqësimi ligjor nga specialistë të sektorit të edukimit, janë disa nga parregullsitë që iu adresuan me letër zyrtare IEVP Peqin, për dijeni DPB

U ngrit dhe u vendos në zbatim linja e gjelbër



Të paraburgosurit/dënuarit e akomoduar në **21 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale** në vendin tonë mund të telefonojnë PA PAGESË pranë stafit të Klinikës së Ligjit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, i cili ofron këshillim ligjor, ndërhyrje institucione sipas problematikës, asistim në plotësimin e dokumentacionit, shërbim avokator falas etj.

04 223 3671

069 40 75 732

068 20 23 699

Ky buletin informues realizohet në kuadër të projektit "Të drejtat e personave të privuar nga liria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore", të mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur.